

Përditësimi i fundit: **26 Korrik 2024**

KUSHTET E PUNËS PËR APLIKACIONIN RAIPAY

Ju lutemi të lexoni në tërësi këto Kushte të Punës përpara vendimit për pranimin e tyre dhe vazhdimin e procesit të regjistrimit. Nëse nuk jeni dakord me ndonjë nga dispozitat e këtyre kushteve që lidhen me Aplikacionin RaiPay, ju lutemi të mos hyni ose përdorni programin, funksionalitetet, informacionin, materialin ose elementë të tjerë të përfshirë në Aplikacion.

Këto Kushte të Punës zbatohen së bashku me Kontratën/Marrëveshjen për Kartën e Debitit/ Kartën e Kreditit të lidhur midis Klientit/ Përdoruesit dhe Bankës dhe përbëjnë marrëveshjen e lidhur midis Klientit/Përdoruesit dhe Bankës, për instalimin dhe përdorimin e Aplikacionit RaiPay.

Ju mund të gjeni një video udhëzuese këtu: <https://www.raiffeisen.al/raipay/>

I. PËRKUFIZIMET

“Banka”/“Raiffeisen Bank” - Raiffeisen Bank Sh.a., me seli në Rr.”Kavajës”, Tirane, regjistruar në regjistrin tregtar me Numrin Unik të Identifikimit të Subjektit J61911005B.

“Kartë” - pajisje fizike e cila mund të përdoret nga Klienti për të kryer veprime pagese ose tërheqje mjeteve monetare. Kjo kategori përfshin Kartat e Debitit dhe Kartat e Kreditit të lëshuara nga Banka.

“Tokenizim i kartës” - procesi i digjitalizimit të të dhënave sensitive të kartës dhe gjenerimit të një numër 16-shifror (Token), të ndryshëm nga ai i printuar në kartën fizike, i nevojshëm për kryerjen e pagesave elektronike në mënyrë më të sigurt dhe i aksesueshëm përmes portofolit digjital (RaiPay).

“Klient/Përdorues” - klienti i Bankës që është përdorues i një Karte Debiti kryesore, Karte Debiti shtesë dhe / ose Karte Krediti kryesore, Karte Krediti shtesë.

"Fjalëkalimi i aplikacionit" - kodi i sigurisë i formuar nga 4 shifra, i vendosur kur aplikacioni është instaluar ose, nëse është ndryshuar nga Përdoruesi, që përdoret për të autorizuar pagesa me vlerë të lartë (> 10,000 Lekë) dhe gjithashtu, në situata të tjera kur nevojitet një masë shtesë e sigurisë.

“Aplikacioni RaiPay”/“Aplikacioni” - aplikacion Mobile për smartphone me sistem operativ Android dhe IOS, që jep mundësinë për regjistrimin e kartave të lëshuara nga banka. Kartat e regjistruara në aplikacion mund të përdoren për pagesa dhe tërheqje përmes teknologjise “NFC” - “Near Field Communication” nga pajisjet celulare me sistem operativ Android. Ky aplikacion nuk suporton pagesat dhe tërheqjet në pajisjet celulare me sistemin operativ IOS.

“Karta e Besnikërisë” - kartë plastike apo virtuale me një numër unik identifikimi e cila është lëshuar nga një tregtar. Duke përdorur këtë kartë, Konsumatori merr pjesë në programin e Besnikërisë të Tregtarit në bazë të Kushteve të punës të këtij programi.

“NFC”/ “Transmetim të dhënash pa kontakt” - teknologji që lejon transferimin e të dhënave midis dy pajisjeve në distanca shumë të afërta përmes antenave në pajisje. NFC përdoret për të bërë pagesa pa kontakt në POS dhe tërheqje nga ATM-ja me anë të kartave ose telefonit celular. (Vetëm në pajisjet me sistem operativ Android)

“Transferta të menjëhershme parash nga kartë në kartë” / “Transferta nga karta në karta” (P2P) – transfera parash nga një kartë në tjetrën, bazuar në teknologjitë vijuese: “MoneySend” nga Mastercard dhe “Visa Direct” nga Visa, të njohura gjithashtu si pagesa ndërmjet personave (P2P). Me këto transferime, paratë dërgohen nga një kartë debiti ose krediti, Visa ose Mastercard, e regjistruar në aplikacionin RaiPay dhe e lëshuar nga Raiffeisen Bank në Shqipëri, në një tjetër kartë, Visa ose Mastercard, të lëshuar nga bankat në Shqipëri ose jashtë saj (vendet e BE-së, vendet e Rajonit të Ballkanit, Ukrainë, Mbretëria e Bashkuar dhe Turqia).

“Kodi i Verifikimit” - kod alfanumerik i cili do të përdoret gjatë aktivizimit dhe lidhjes së RaiPay përmes Pikës së Kontaktit me bankën, nëse aktivizimi i aplikacionit RaiPay, zgjidhet nga klienti apo për arsye teknike, nuk do të kryhet përmes aplikacionit të Mobile Banking të bankës (Raiffeisen ON Albania).

“Kushtet e Punës” - përcaktojnë mënyrën me të cilën mund të regjistroheni në Aplikacionin RaiPay dhe të përdorni Kartat e lëshuara nga Raiffeisen Bank. Këto kushte pune, bashkë me Marrëveshjen specifike që është lidhur midis Klientit/Përdoruesit dhe Bankës, në lidhje me përdorimin e Kartës së Debitit/Kartës së Kreditit, përbëjnë marrëveshjen e lidhur midis Bankës dhe Klientit, për përdorimin e Aplikacionit RaiPay, respektivisht për të hyrë dhe për të përfituar nga funksionet e ofruara nga Aplikacioni RaiPay.

2. Si funksionon Aplikacioni RaiPay?

Përdoruesi duhet të jetë klient i Bankës ose duhet të jetë i regjistruar/autorizuar në sistemin e Bankës dhe të jetë titullar i një Karte Debiti kryesore, Karte Debiti shtesë, Kartë krediti kryesore ose shtesë sipas rastit, ku të paktën një prej tyre të jetë aktive.

Duke përdorur Aplikacionin RaiPay mund të kryhen shërbimet më poshtë:

- regjistrim i kartave të Përdoruesit dhe leximi i detajeve të Kartës (imazhi, 4 shifrat e fundit të serisë së kartave, numri i kartës, data e skadencës, CVV, PIN i kartës) të regjistruara nga Përdoruesit;
- pagesa pa kontakt/(Contactless)/ tërheqje nga ATM përmes (NFC), vetëm për pajisje me sistem operativ Android, duke përdorur pajisjen tuaj celulare me ndonjë prej kartave të regjistruara në Aplikacion;
- transfera parash nga karta në kartë përmes teknologjive: Money Send -Mastercard dhe Visa Direct VISA;
- leximi i katër (4) shifrave të fundit të numrave të Kartave dhe transaksioneve të iniciuara me këto Karta;
- lexim i balancës në dispozicion për kartën e kreditit në kohë reale;
- lexim i transaksioneve të iniciuara nga aplikacioni, për kartat e debitit dhe kreditit;
- lexim i historikut të transaksioneve;
- ndryshimi i emërimit për një ose disa prej kartave të regjistruara;
- vendosja e një karte si e paracaktuar për veprime;
- vendosje e një fjalëkalimi të domosdoshëm për të autorizuar pagesa me vlerë të lartë dhe ndryshimin e këtij fjalëkalimi.

Pagesat dhe tërheqjet me anë të teknologjisë NFC ofrohen vetëm në pajisjet celulare me sistemin operativ Android. Ndërsa transfertat e parave nga karta në kartë, ofrohen si për pajisjet me sistemin Android ashtu edhe për pajisjet me sistemin IOS.

3. Si të hyni/regjistroheni në aplikacionin RaiPay ?

Përdoruesit mund të gjejnë detaje mbi Aplikacionin RaiPay dhe funksionalitetet e tij duke hyrë në internet

<https://www.raiffeisen.al/raipay/>

Për të instaluar dhe përdorur Aplikacionin RaiPay, Klienti duhet :

- të ketë një pajisje celulare me një sistem operativ Android (versioni i sistemit operativ duhet të jetë Android 8.0 ose më lartë) ose IOS (Versioni i sistemit operativ duhet të jetë 15.0 ose më lartë);
- të shkarkojë aplikacionin RaiPay nga dyqanet zyrtare Google Play Store ose App Store
- pajisja celulare duhet të jetë e lidhur në internet dhe të jetë e kycur (Ekran i kyçjes me PIN, fjalëkalim ose biometrik);
- të pranojë Kushtet e Punës;
- të lidhë marrëveshje me Bankën për Aplikacionin RaiPay duke instaluar Aplikacionin RaiPay dhe duke pranuar këto Kushte të Punës.
- të japë pëlqimet/lejet e kërkuara nga Aplikacioni (p.sh. NFC, etj.);
- të vendosë një fjalëkalim (“Security Passcode”/ “Kod Sigurie”) për Aplikacionin i cili do të përdoret për të autorizuar transaksionet ose për të parë historikun e transaksioneve të kryera me kartat e regjistruara në Aplikacion. Për sigurinë e transaksioneve të kryera përmes Aplikacionit dhe pavarësisht nga vlera e tij, Klienti ka mundësinë të kërkojë vendosjen e fjalëkalimit të Aplikacionit ose zhblokimin e pajisjes celulare të përdorur për kryerjen e pagesave mbi limitin e përcaktuar.
- të përfundojë regjistrimin në aplikacionin RaiPay, në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) duke përfunduar aktivizimin dhe lidhjen përmes mobile banking (Raiffeisen ON Albania);

b) Nëse klienti nuk e ka aplikacionin mobile banking, (Raiffeisen ON Albania), të aktivizuar dhe nuk dëshiron ta shkarkojë atë, apo në rastet kur nuk arrihet të bëhet aktivizimi nëpërmjet RON, aktivizimi mund të bëhet përmes një thirrjeje telefonike në pikën e kontaktit të Bankës. Është e detyrueshme që thirrja të kryhet përmes një numri telefoni që klienti e ka të regjistruar në sistemin e Bankës.

Në rast se Klienti nuk mund të identifikohet përmes telefonatës në Pikën e Kontaktit, aktivizimi i Aplikacionit RaiPay përmes telefonatës, mund të refuzohet. Pas aktivizimit të suksesshëm të RaiPay, të gjitha kartat bankare, për të cilat Përdoruesi është gjithashtu kartëmbajtës do të shfaqen dhe mund të përdoren përmes aplikacionit RaiPay. Përdoruesi mund të zgjedhë njerën prej tyre për të përdorur për Pagesa dhe Tërheqje pa Kontakt me Telefonin Celular. **(Pagesat pa kontakt dhe tërheqjet në ATM nuk ofrohen për sistemet operative IOS)**

Banka ruan të drejtën në një moment të caktuar të ofrojë vetëm një nga dy metodat e regjistrimit shprehura si më sipër.

Komisionet për mirëmbajtjen e llogarisë dhe kryerjen e transaksioneve, pagesave dhe tërheqjeve i janë paraqitur në mënyrë të qartë Përdoruesit në Kontratën e llogarisë Rrjedhëse dhe Marrëveshjen për përdorimin e Kartës së Debitit/Kartës së Kreditit.

Instalimi dhe përdorimi i Aplikacionit RaiPay, do të jetë pa asnjë komision në ngarkim të klientit. Gjithsesi banka rezervon të drejtën që gjatë periudhës në vazhdim, të vendosë aplikimin e një komisioni për përdorimin e Aplikacionit RaiPay.

Aplikimi i komisionit do të bëhet vetëm mbasi klienti të ketë dhënë pëlqimin e tij nëpërmjet aplikacionit, se dëshiron të vazhdojë përdorimin e këtij aplikacioni, kundrejt pagesës së komisionit përkatës.

4. Aktivizimi i Kartave nëpërmjet NFC

Përdoruesit mund të shtojnë në Aplikacionin RaiPay, duke ndjekur një nga metodat e shpjeguara në pikën 3, të këtyre kushteve të punës, vetëm Kartat aktive të lëshuara nga Raiffeisen Bank (Albania) për:

a) personat fizikë / individë – Kartat e Debitit dhe / ose të Kreditit të lëshuara në emër të Titullarit ose kartave shtesë (karta të lëshuara nga Banka për llogarinë bankare të Klientit,

me kërkesë të këtij të fundit, në emër të një të treti të përcaktuar nga Klienti) i regjistruar në sistemin e Bankës si i tillë;

b) personat juridikë – Kartat e debitit dhe / ose të kreditit të lëshuara në emër të Përdoruesve të Kartave të Biznesit.

Pas shfaqjes së Kartave aktive në Aplikacion, në mënyrë që të vijohet me përdorimin përmes teknologjisë NFC (vetëm për përdoruesit e pajisjeve me sistem operativ Android), do të duhet të kryhet edhe tokenizimi i tyre (“Aktivizimi NFC”).

Duke përfunduar procesin e tokenizimit të kartës, Klienti e kupton që Karta mund të përdoret për veprimet e pagesave, përkatësisht veprime pa kontakt duke përdorur teknologjinë NFC dhe për leximin e transaksioneve të kryera me Kartë në Aplikacion.

Aplikacioni suporton pagesat dhe tërheqjet vetëm në sistemet operative Android dhe jo në pajisjet celulare me sistemin operativ IOS.

5. Vërtetimi i përdoruesit për të hyrë dhe përdorur aplikacionin RaiPay.

Aplikacioni mund të përdoret vetëm nëse pajisja celulare është e sigurt me një fjalëkalim, gjurmë gishti ose një metodë tjetër sigurie të dhënë nga pajisja. Sigurimi i pajisjes duhet të mirëmbahet gjatë gjithë përdorimit të Aplikacionit, përfshirë regjistrimin e Kartave, përndryshe Aplikacioni nuk do të funksionojë.

Klienti kupton dhe pranon që është përgjegjës për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e sigurisë së informacionit / të dhënave për hyrjen në Aplikacion dhe përdorimin e Aplikacionit.

Aplikacioni RaiPay do të përdoret vetëm nga Klienti. Transferimi i tij tek një palë e tretë është i ndaluar. Aplikacioni RaiPay mund të përdoret vetëm me terminale POS që mundësojnë përdorimin e teknologjisë pa kontakt me pajisjen celulare, në Shqipëri dhe jashtë saj.

Klienti duhet menjëherë dhe pa vonesë të informojë Raiffeisen Bank në rast të humbjes, vjedhjes, marrjes së paligjshme ose përdorimit të paautorizuar të informacionit / të dhënave për hyrjen dhe përdorimin e Aplikacionit, si dhe të pajisjes celulare të përdorur. Për më tepër, ai/ajo duhet të njoftojë menjëherë Raiffeisen Bank, pa vonesë për ndonjë shkelje të njohur të konfidencialitetit / sigurisë.

Nëse metoda e zhblllokimit të pajisjes celulare përfshin disa gjurmë gishtërinjsh ose disa profile të autorizuar për njohjen e fytyrës (brenda sistemit operativ), secili profil i tillë do të hapë Aplikacionin RaiPay, si rezultat, kjo metodë e hyrjes duhet të përdoret vetëm nga Përdoruesi i Aplikacionit RaiPay, pa regjistrimin e gjurmëve të gishtërinjve të palëve të treta, për të shmangur aktivitetet e mundshme mashtruese ose hyrjen e paautorizuar, përfshirë hyrjen në historikun e transaksioneve të inicuar/realizuara brenda Aplikacionit nga Përdoruesi.

Raiffeisen Bank gjithashtu rekomandon të mos zbuloni metodën e zhblllokimit të telefonit dhe të mos zbuloni fjalëkalimin e Aplikacionit për njerëzit e tjerë. Duke u mundësuar palëve të treta të hyjnë në pajisjen celulare ose fjalëkalimin e Aplikacionit, ju merrni përgjegjësinë për të gjitha transaksionet e autorizuar në këtë mënyrë.

Gjashtë (6) tentativa të njëpasnjëshme të vendosjes së fjalëkalimit të gabuar do të shkaktojnë bllokimin e hyrjes për përdoruesit në Aplikacion për arsye sigurie. Zhblllokimi mund të bëhet vetëm duke kontaktuar Qendrën e Kontaktit në numrat e telefonit të treguar në pikën 13 “Ndihmë” të këtyre kushteve të punës.

6. Çfarë mund të bëni në RaiPay ?

Funksionalitetet e disponueshme brenda Aplikacionit RaiPay janë përshkruar më poshtë. Ndërsa funksionet shtesë që do të bëhen të disponueshme, do të komunikohen në faqen zyrtare të internetit:

<https://www.raiffeisen.al/raipay/> dhe do të shfaqen në Aplikacion.

Me hyrjen në Aplikacion dhe përdorimin e tij, Përdoruesi bie dakort me funksionet e reja dhe kjo nënkupton dhënien e pëlqimit për përdorimin e tyre, sipas Kushteve të Punës të përcaktuara nga Banka.

A- Pagesa me pajisjen celulare (vetëm për sistemin Android)

Kartat e regjistruara në Aplikacion, mund të kryejnë pagesa pa kontakt, tek tregtarët e autorizuar që kanë instaluar terminale POS me teknologjinë pa kontakt. Për veprimet e pagesave duke përdorur teknologjinë pa kontakt, Përdoruesi konsiderohet se ka shprehur

pëlqimin e tij / saj për kryerjen e veprimeve të pagesave duke lëvizur/afuar pajisjen celulare ku Aplikacioni është instaluar, afër një terminali POS me teknologji pa kontakt, bazuar në metodën e përshkruar më poshtë. Në disa raste, Aplikacioni lejon që transaksionet të kryhen edhe në rast se në pajisjen celulare nuk ka lidhje interneti.

Metoda e autorizimit të pagesës është e ndryshme në varësi të vlerës së saj, si më poshtë:

- ü Për transaksione deri në 2,000 Lekë (përfshirë), pajisja celulare e kyçur vendoset afër terminalit POS, me ekranin e ndezur dhe është në gjendje të kryejë transaksione deri në një vlerë akumulative maksimale 12,000 ALL.

- ü Për transaksione midis 2,000 Lekë dhe 10,000 Lekë (përfshirë), pajisja celulare e çkyçur duke përdorur metodën e përcaktuar të çkycjes së ekranit, vendoset afër terminalit POS;

- ü Për transaksione që tejkalojnë 10,000 Lekë, pajisja celulare e kyçur me një fjalëkalim / biometrikë vendoset afër terminalit POS dhe kërkohet vendosja e fjalëkalimit të Aplikacionit (fjalëkalimi i vendosur me instalimin e Aplikacionit).

Çdo ndryshim në vlerën e pagesës dhe metodës së autorizimit do të njoftohet nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të bankës.

Limitet maksimale për kryerjen e transaksioneve nëpërmjet pajisjes celulare dhe Aplikacionit RaiPay janë të njëjta me limitet e përcaktuara për veprimet me karta sipas Kontratës/Marrëveshjes së Kartës së Debitit/Kartës së Kreditit të lidhur me Raiffeisen Bank dhe përdoruesit. Këto limite mund të gjënden të publikuara edhe në faqen zyrtare të bankës: www.raiffeisen.al

Për sigurinë e transaksioneve të kryera përmes Aplikacionit dhe pavarësisht nga vlera e tij, përveç kërkesës për hyrjen e fjalëkalimit të Aplikacionit ose zhbllokimin e pajisjes celulare të përdorur për kryerjen e pagesave, përdoruesi gjithashtu ka mundësinë që të mundësojë funksionin “Eksperienca e pagesës NFC”, duke përzgjedhur një prej opsioneve:

- o “Paguaj shpejt” – të gjitha transaksionet më të mëdha se 2,000 lekë do të autorizohen duke përdorur metodën e përcaktuar të çkycjes së ekranit. Nëse pajisja është e çkyçur dhe nuk ka patur një veprim çkyçjeje gjatë minutës së fundit, autorizimi jepet nëpërmjet fjalëkalimit të aplikacionit/ vërtetimi i shenjës së gishtit.

- o “Paguaj me zgjuarsi” – për të gjitha transaksionet më të mëdha se 2,000 lekë do të kërkohet autorizimi nëpërmjet fjalëkalimit të aplikacionit/ vërtetimi i shenjës së gishtit.

o “Paguaj rreptesisht” – të gjitha transaksionet do të kërkojnë autorizim nëpërmjet fjalëkalimit të aplikacionit/ vërtetimi i shenjës së gishtit (përfshirë: nëse ka patur një veprim ckycjeje gjatë minutës së fundit).

Transaksionet e iniciuara dhe të autorizuar nga Aplikacioni RaiPay mund të kryhen sipas Kontratës / Marrëveshjes së Kartës së Debitit/ Kartës së Kreditit të lidhur ndërmjet Klientit/Përdoruesit dhe Bankës, e zbatueshme për kartëmbajtësit. Llogaria përkatëse e Kartës së Debitit / Kartës së Kreditit do të debitohet me të gjitha transaksionet e realizuara me Aplikacionin RaiPay.

Për më tepër, Aplikacioni mund të kryejë, përmes kartave të regjistruara, veprime të tërheqjes së parave në ATM që lejojnë përdorimin e Aplikacionit. Për tërheqjen e parave në ATM, kërkohet vendosja e PIN-it të kartës gjithashtu në terminalin e ATM-së.

B) Transferta të shpejta nga karta në kartë (P2P) nga RaiPay, përmes teknologjive Money Send nga Mastercard dhe Visa Direct nga Visa

Klientët që zotërojnë karta debiti apo krediti të lëshuara nga banka raiffeisen dhe që tashmë i kanë të regjistruara në aplikacionin RaiPay, kanë mundësinë të kryejnë transferta të shpejta të fondeve nga karta në kartë (“P2P money transfers”) me teknologjitë e ofruara nga kartat e brand-eve “Mastercard” dhe “Visa” të lëshuara nga banka Raiffeisen.

Transfertat e shpejta të parave P2P, të iniciuara dhe të autorizuar nga Aplikacioni RaiPay, do të kryhen duke u bazuar në kushtet e punës, si dhe duke aplikuar komisionet e përcaktuara në Kontratën / Marrëveshjet e Kartës së Debitit/ Kartës së Kreditit të lidhur ndërmjet Klientit/Përdoruesit dhe Bankës.

Llogaria përkatëse e Kartës së Debitit / Kartës së Kreditit do të debitohet për të gjitha transfertat nga karta në kartë.

Transfertat e parave nga karta në kartë në aplikacionin RaiPay mund të kryhen në monedhat Lekë dhe Euro, sipas zgjedhjes së vetë Përdoruesit/Klientit. Llogaria përkatëse e Kartës së Debitit/Kreditit do të debitohet me vlerën e përcaktuar nga klienti në të njëjtën monedhë, ose ekuivalenti i kësaj vlere, duke aplikuar kursin e këmbimit ditor të bankës, nëse monedha e përzgjedhur në aplikacion, ndryshon nga monedha në të cilën karta është lëshuar.

Transfertat e parave nga karta në kartë (P2P), ofrohen dhe mund të kryhen drejt të gjitha kartave të brand-eve Mastercard dhe Visa, të lëshuara brenda Shqipërisë dhe jashtë saj në vëndet:

- E zonës së Bashkimit European
- E Rajonit të Ballkanit (Kosove, Mal i Zi, Maqedoni, Bosnje dhe Hercegovine, Serbi)
- E Mbretërisë së Bashkuar (Angli, Skoci, Irlandë, Irlandë e Veriut, Wells)
- Ukrainë
- Turqi

Limitet dhe komisionet për këtë funksionalitet janë të shprehura në tabelën e mëposhtme, si dhe në tabelat e komisioneve në Kontratat/Marrëveshjet e Kartës së Debitit/Kreditit të lidhura ndërmjet Klientit/Përdoruesit dhe Bankës.

	P2P nga Kartë Debiti RBAL	LEK	EUR
1	Totali I limitit ditor për transferta P2P	50,000	500
2	Totali I limitit javor për transferta P2P	250,000	2,500
3	Totali I limitit mujor për transferta P2P	1,000,000	10,000
4	Totali I numrit ditore të transfertave P2P	10	10
5	Totali I numrit javore të transfertave P2P	50	50
6	Totali I numrit mujore të transfertave P2P	200	200

	P2P nga Kartë Krediti RBAL	LEK	EUR
1	Totali I limitit ditor për transferta P2P	50,000	500
2	Totali I limitit javor për transferta P2P	250,000	2,500
3	Totali I limitit mujor për transferta P2P	1,000,000	10,000
4	Totali I numrit ditore të transfertave P2P	10	10
5	Totali I numrit javore të transfertave P2P	50	50
6	Totali I numrit mujore të transfertave P2P	200	200

Transferta nga Karta në Kartë nga RaiPay (P2P)	LEK	EUR
Komisioni për transferta midis Kartave të lëshuara nga RBAL	0	0
Komisioni për transferta drejt kartave VISA dhe Mastercard brënda Shqipërisë	2% e vlerës së transfertës (Min 500)	2% e vlerës së transfertës (Min 5)
Komision për transferta drejt kartave VISA dhe Mastercard Jashtë Shqipërisë	2.5% e vlerës së transfertës (Min 750)	2.5% e vlerës së transfertës (Min 7.5)

C) Historiku i transaksioneve të iniciuara/realizuara me Aplikacion

Përdoruesi mund të lexojë:

- Transaksionet e iniciuara duke përdorur Aplikacionin (vetëm nga pajisjet me sistemet operative Android)
- Transaksionet e iniciuara në 30 ditët e fundit (maksimumi 60 transaksione) duke përdorur kartën dhe/ose Aplikacionin. Përdoruesi ka mundësinë të zgjedhë të shohë vetëm veprimet e iniciuara përmes Aplikacionit për secilen nga kartat ose të gjitha transaksionet me kartat të iniciuara përmes Aplikacionit
- Balancën në dispozicion për kartën e kreditit.

D) Parametra

Përdoruesi ka opsionet dhe informacionet e mëposhtme në menunë “Parametra” të Aplikacionit:

- Ndryshon ngjyrat e Aplikacionit;
- Ndryshon gjuhën e aplikacionit;

- Shfaq balancën në dispozicion;
- Shfaq historikun e transaksioneve;
- Karakteristikat e fjalëkalimit;
- Ndryshon fjalëkalimin - kërkohet hyrja e fjalëkalimit ekzistues për ta ndryshuar atë;
- Eksperienca e pagesës NFC (Vetëm në pajisje me sistem operativ Android) –
 - o “Paguaj shpejt” – dhe në këtë rast të gjitha transaksionet më të mëdha se 2,000 lekë do të autorizohen duke përdorur metodën e përcaktuar të çkycjes së ekranit me fjalëkalimin e Aplikacionit. Nëse pajisja është e çkyçur dhe nuk ka patur një veprim çkycjeje gjatë minutës së fundit, autorizimi jepet nëpërmjet fjalëkalimit të aplikacionit / vërtetimi i shenjës së gishtit.
 - o “Paguaj me zgjuarsi” – për të gjitha transaksionet më të mëdha se 2,000 lekë do të kërkohej autorizimi nëpërmjet fjalëkalimit të aplikacionit/ Vërtetimi i shenjave të gishtërinjve.
 - o “Paguaj rreptësisht” – të gjitha transaksionet do të kërkojnë autorizim nëpërmjet fjalëkalimit të aplikacionit/ vërtetimi i shenjës së gishtit (përfshirë: nëse ka patur një veprim çkycjeje gjatë minutës së fundit).
- Aplikacioni i pagesës së paracaktuar (vetëm për pajisje me sistem operativ Android)– duke aktivizuar këtë funksionalitet, Aplikacioni do të vendoset në parazgjedhje, duke zëvendësuar aplikimet e tjera të pagesave që ekzistojnë në një pajisje të tillë;
- Vërtetimi i shenjës së gishtit – duke aktivizuar këtë opsion, shenjat e gishtit do të përdoren për të autorizuar transaksionet e kryera përmes Aplikacionit
- Mbarimi i seancës 1 minutë (1 minute Dalja nga Sesioni) - duke aktivizuar këtë opsion, Përdoruesi do të mbetet i verifikuar në Aplikacion edhe për 1 minutë mbas mbylljes së tij.
- Kontakti – tregon informacionin e kontaktit të Bankës për qëllime mbështetjeje;
- Kushtet e Punës;
- Versioni i aplikacionit;
- Disa parametra të aplikacionit mund të aksesohen me anë të një autentifikimi të mëtejshëm, nëpërmjet vërtetimit të shenjës së gishtit ose PIN e Aplikacionit;
- o Shfaq të dhënat e kartës;
- o Shfaq PIN-in e kartës;

- o Bllokon përkohësisht kartën;

E) Kartat e Besnikërisë

Përdoruesi mund të regjistrojë kartat e tij të besnikërisë të lëshuar nga tregtarë të ndryshëm nëpërmjet opsioneve të mëposhtme:

- Duke përzgjedhur tregtarin për të cilin dëshiron të regjistrojë kartën e tij të besnikërisë nga lista e paracaktuar;
- Duke shtuar manualisht një kartë besnikërie të një tregtari i cili nuk është pjesë e listës së paracaktuar;

Kartat e besnikërisë mund të shtohen:

- o Duke skanuar barkodin e kartës;
- o Duke regjistruar manualisht numrin e kartës;

Përdoruesi ka mundësinë të emërtojë kartat e tij të besnikërisë sipas preferences.

Regjistrimi i kartave të besnikërisë bëhet nën përgjegjësinë e përdoruesit të aplikacionit, sipas marrëdhënies që vetë Përdoruesi ka me Tregtarin që ka lëshuar kartën.

Varet nga versioni i Aplikacionit nëse parametrat e shtuara mund të aksesohen. Banka nuk do të jetë përgjegjëse nëse Përdoruesi përdor një version që nuk disponon parametrat e shtuara, dhe as nëse një apo më shumë nga parametrat e shtuara nuk janë përkohësisht në dispozicion.

7. Deklarimet dhe Garancitë e Klientit

Për qëllimin e përdorimit të Aplikacionit RaiPay, ju deklaroni dhe garantoni se:

- jepni pëlqimin për përpunimin e mëtejshëm të informacionit të dhënë prej jush tek Raiffeisen Bank, vetëm për qëllimin e aksesimit të: <https://play.google.com/store/apps/details?id=al.raiffeisen.mobilepay>

për të cilin keni deklaruar vullnetarisht të dhënat tuaja personale

- ju keni të drejtën, autoritetin dhe aftësinë e plotë të veprimit;
- keni në zotërim pajisjen ku keni shkarkuar Aplikacionin RaiPay
- ju zotëroni aftësinë si Përdorues i një Karte kryesore, shtesë Krediti dhe/ose debiti sipas rastit, që të regjistrohet dhe ruhet në Aplikacionin RaiPay.

- ju është dhënë e drejta për të regjistruar, ruajtur dhe përdorur Kartën e Debitit / Kartën e Kreditit në Aplikacion, me qëllim të kryerjes së pagesave nëpërmjet pajisjes celulare;
- nuk e komunikoni fjalëkalimin për zhblokimin e pajisjes një palë të tretë, pasi duke zbuluar një fjalëkalim të tillë, ju jeni të ekspozuar ndaj rrezikut që Kartat tuaja të përdoren për pagesa nga persona të tjerë;
- ju merrni përsipër të kërkonti nga Përdoruesi kryesor ose mbajtësi i llogarisë së kartës së Biznesit, sipas rastit, informacion në lidhje me përmbajtjen e Marrëveshjes specifike për lëshimin e Kartës së Debitit / Kartës së Kreditit;
- ju merrni përsipër të njoftoni Bankën menjëherë për çdo përdorim të paautorizuar ose ndonjë shkelje të sigurisë së Aplikacionit për të cilën bëheni të vetëdijshëm ose për të cilat duhet të dyshoni në mënyrë të arsyeshme;
- ju merrni përsipër të informoni Bankën në rast të humbjes ose vjedhjes së pajisjes celulare ku është instaluar Aplikacioni RaiPay;
- nuk do të ofroni informacion të gabuar ose të rremë në lidhje me identitetin ose qëllimet tuaja në lidhje me përdorimin e Aplikacionit;
- do të siguronit dhe ruani sigurinë e pajisjes celulare, sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe praktikës së mirë;
- do të rifreskoni sistemin operativ sipas rekomandimeve të prodhuesit të pajisjes celulare dhe se do të përdorni vetëm versionet zyrtare të sistemit operativ të siguruar nga i njëjti;
- nuk do të pengoni mbrojtjen e sigurisë së sistemeve operative të rekomanduara nga prodhuesi i pajisjes celulare;
- do të instaloni vetëm Aplikacionin RaiPay Albania të siguruar nga Banka nga dyqani i dedikuar – Google Play Store ose AppStore;
- nuk do të instaloni aplikacione nga burime jozyrtare, sepse të tilla mund të rrezikojnë sigurinë e Aplikacionit tuaj;
- nuk do të shkelni asnjë të drejtë të parashikuar nga ligji, të drejtat e pronësisë, të drejtat e paprekshme, konfidencialitetin ose të drejtat e të dhënave personale të njerëzve të tjerë;
- nuk do të përdorni përmbajtjen e Aplikacionit në kundërshtim me Kushtet e Punës, përkatësisht për qëllime të paautorizuara, të tilla si, kopjimin, shpërndarjen ose ndryshimin e tij.

- keni lexuar këto Kushte dhe pajtoheni me këto Kushte Pune;
- keni lexuar dhe pranuar nenin 15 më poshtë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale brenda Aplikacionit RaiPay, në mënyrë që të përdorni Aplikacionin;

8. Përfundimi i marrëveshjes, Bllokimi / Pezullimi i Aplikacionit RaiPay

Raiffeisen Bank do të marrë të gjitha masat e nevojshme në rast të përdorimit të këtij Aplikacioni dhe funksioneve të tij në kundërshtim me Kushtet e Punës. Raiffeisen Bank do të monitorojë përdorimin e Aplikacionit për t'u siguruar që përdorimi është në përputhje me këto Kushte dhe që shërbimet janë përdorur në mënyrën e duhur.

• Përfundimi i marrëveshjes

Përfundimi i marrëveshjes për përdorimin e Aplikacionit RaiPay, mund të ndodhë në secilën prej situatave të mëposhtme:

- a) me ndërprerje të njëanshme të shërbimit nga ana e Bankës, nëse Banka konstaton se detyrimet që rrjedhin nga ky dokument, të plotësuar me Marrëveshjen specifike për Kartën e Debitit / Kartën e Kreditit që është lidhur me Bankën, nuk respektohen. Në këtë rast, Banka do të njoftojë Klientin në lidhje me përfundimin e Marrëveshjes, 3 ditë pune përpara.
- b) me përfundimin e njëanshëm nga ana e Klientit, në çdo kohë, duke ç'instaluar Aplikacionin nga pajisja celulare. Përfundimi i Marrëveshjes nga Klienti nuk ndikon në transaksionet e kryera tashmë ose në zhvillim e sipër.

RaiPay nuk jep mundësinë e krijimit të një "Account/Llogari" në aplikacion. Të gjitha informacionet ngarkohen përmes mënyrave të autentifikimit përgjatë regjistrimit të portofolit të kartave të klientit në aplikacion, siç shpjegohen në pikën 3, 'Si të hyni/regjistroheni në aplikacionin RaiPay' të këtyre kushteve.

Nëse klienti zgjedh të fshijë aplikacionin nga pajisja e tij dhe vendos më pas ta riinstalojë atë, për të pasur mundësinë e përdorimit të aplikacionit, do t'i duhet të krijojë portofolin e tij digjital nga e para, duke ndjekur të gjitha hapat e procesit të regjistrimit të përshkruara në pikën 3, 'Si të hyni/regjistroheni në aplikacionin RaiPay'.

• Bllokimi / Pezullimi i Aplikacionit RaiPay

Banka rezervon të drejtën të bllokojë/pezullojë ose kufizojë përdorimin e Aplikacionit RaiPay, të mos fillojë ose të kryejë një ose disa transaksione, për të bllokuar instalimin/riinstalimin e Aplikacionit, nëse:

- (i) Banka është njoftuar që pajisja ku është instaluar Aplikacioni është humbur, vjedhur, kompromentuar ose që Aplikacioni RaiPay është kopjuar, vjedhur, bërë i papërdorshëm ose

është objekt i funksionimit të gabuar. Masa e bllokimit / pezullimit do të merret pasi Klienti ka njoftuar Bankën në lidhje me ndodhjen e kësaj ngjarje;

(ii) Banka ka dyshime në lidhje me përdorimin e paautorizuar / mashtrimit të Aplikacionit ose në lidhje me kryerjen e transaksioneve mashtruese/të paligjshme përmes Aplikacionit;

(iii) Klienti ka dështuar të respektojë dispozitat ligjore dhe/ose kontraktuale, duke përfshirë shkeljen e kushteve të punës ose deshton në respektimin e rregullave të një sjelljeje të përshtatshme, të cilat mund të çojnë në krjimin e dyshimeve nga ana e Bankës, si p.sh. por pa u kufizuar në dhënien e informacionit të rremë nga Klienti, mosrespektimin e masave të sigurisë së Aplikacionit RaiPay, etj.

(iv) Është miratuar një dispozitë ligjore që e urdhëron një gjë të tillë ose është marrë një vendim nga një autoritet kompetent për këtë qëllim;

(v) Fjalëkalimi i Aplikacionit është vendosur gabimisht disa herë;

Për më tepër, Banka mund të bllokojë/zhbllokojë ose ndryshojë menjëherë Aplikacionin RaiPay, për arsye objektive, siç janë domosdoshmëria e kryerjes së proceseve të mirëmbajtjes ose riparimit. Periodikisht, Banka mund të shtojë funksione të reja dhe nuk ka ndonjë detyrim të ofrojë një funksion të caktuar për Aplikacionin RaiPay.

Ju pranoni që Banka nuk do të jetë përgjegjëse ndaj jush ose ndonjë palë tjetër për bllokimin, pezullimin, anulimin ose përfundimin e përdorimit të ndonjë Karte të regjistruar në Aplikacion.

Raiffeisen Bank do t'ju informojë paraprakisht, ose nëse një gjë e tillë nuk është e mundur, menjëherë pas bllokimit / pezullimit të përdorimit të Aplikacionit, duke specifikuar arsyet e bllokimit / pezullimit , përveç nëse siguri i një informacioni të tillë mund të rrezikojë masat e arsyeshme të sigurisë ose nëse shkelin ligjin. Raiffeisen Bank do të riaktivizojë Aplikacionin, në varësi të situatës, sa më shpejt të jetë e mundur, pasi të eliminojë arsyet që kanë përcaktuar bllokimin/pezullimin në radhë të parë.

9. Ndryshimi i Kushteve Punës të Aplikacionit RaiPay

Banka mund t'i ndryshojë këto Kushte të Punës në çdo kohë, duke publikuar Kushtet e Punës të ndryshuara në Aplikacionin RaiPay. Në rast se ndryshimet lidhen me komisionet e aplikuara për aplikacionin RaiPay, përdoruesit do të njoftohen të paktën 30 ditë para datës së propozuar për hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve. Ky afat 30 ditor nuk do të zbatohet për ndryshimet që bëhen si rrjedhojë e aplikimit të dispozitave të reja ligjore, duke qënë se

ndryshime të tilla zbatohen me hyrjen në fuqi të rregulloreve përkatëse, si dhe në rastet e përmirësimeve (ose perditësimeve) teknike apo në funksionalitete .

Në të gjitha këto raste, përdorimi i aplikacionit prej klientit konsiderohet pranim i kushteve të punës prej tij. Njoftimi i ndryshimit të kushteve të punës do të kryhet prej bankës nëpërmjet publikimit në faqen e saj të internetit, ose me sms, ose me e-mail, ose nëpërmjet aplikacionit RON ose kanaleve të tjera të komunikimit. Nëse Përdoruesi nuk është dakord me ndryshimet, duhet të ç’instalojë Aplikacionin. Ç’instalimi i Aplikacionit do të gjenerojë vetëm efekte në të ardhmen, dhe nuk do të ndikojë në periudhën para ç’instalimit, ku përdorimi i Aplikacionit nga Përdoruesi do të konsiderohet se përputhet plotësisht me këto Kushte.

Nëse funksionet e reja të Aplikacionit do të zbatohen, ato do t’i nënshtrohen rregullave të parashikuara këtu.

10. Pronësia intelektuale

Përdoruesi shprehimisht deklaron se ai/ajo ka pranuar faktin se i gjithë krijimi grafik, përmbajtja e Aplikacionit dhe materiali audio-video që përdoren janë në pronësi të Bankës. Informacioni, elementet grafike të subjekteve të tjera janë të përjashtuar nga ky rregull, pasi ato janë në pronësi të këtyre subjekteve.

Përdoruesi pranon që çdo program/softuer i përdorur në lidhje me Aplikacionin, përmban informacion konfidencial dhe i nënshtrohet një të drejte pronësie, duke u mbrojtur nga ligjet në lidhje me pronësinë intelektuale, industriale dhe ligje të tjera të zbatueshme.

Përdoruesi merr përsipër të mos përsërisë, kopjojë, shesë ose të përdorë përmbajtjen e Aplikacionit, informacionin dhe/ose materialet audio / video, në të cilat ai/ajo ka qasje, si rezultat i përdorimit të një Aplikacioni të tillë, në tërësi ose pjesërisht.

Përdoruesi e ka të ndaluar të ndryshojë, kopjojë, marrë me qira, japë me qira, shesë, shpërndajë ose krijojë nënprodukte bazuar në funksionalitetet ose programet e përdorura brenda Aplikacionit.

11. Për çfarë nuk jemi përgjegjës

Banka ofron Aplikacionin RaiPay vetëm për përdorimin personal të Klientëve. Klienti është përgjegjës për përdorimin e Aplikacionit, përkatësisht për të gjitha transaksionet e autorizuar duke përdorur pajisjen celulare ku është instaluar Aplikacioni.

Raiffeisen Bank nuk mund të jetë përgjegjës për efektet e krijuara nga përdorimi i Aplikacionit në kundërshtim me këto Kushte nga Përdoruesit ose Palët e treta, për kostot e mundshme të shkaktuara nga përdorimi i Aplikacionit ose nga hyrja e autorizuar ose e paautorizuar e palëve të treta tek nje informacion i caktuar personal dhe/ose konfidencial ose tek të dhënat personale përmes Aplikacionit.

Nëse lejohen palë të tjera të treta të përdorin pajisjen celulare ose fjalëkalimin e Aplikacionit, klienti është përgjegjës për të gjitha transaksionet e autorizuar në këtë mënyrë.

Për të kufizuar pasojat e mundshme të shkaktuara nga përdorimi i Aplikacionit nga palë të treta, Raiffeisen Bank rekomandon që të mos tjetërsoni / huazoni pajisjen celulare, as të zbuloni metodën e zhbllokimit të një pajisje të tillë, as të zbuloni fjalëkalimin e Aplikacionit.

Raiffeisen Bank nuk mund të kontrollojë sistemin e funksionimit të pajisjes së përdorur nga klienti. Prandaj, Raiffeisen Bank nuk do të jetë përgjegjës në asnjë mënyrë për pasojat e shkaktuara në pajisjen celulare, duke përfshirë, pa asnjë kufizim të ndonjë shkelje sigurie të shkaktuar nga viruse, gabime, phishing, falsifikim, mosveprim, ndërprerje, gabim, vonesë në operacione ose transmetime, linja të kompjuterizuara ose dështime të rrjetit ose ndonjë defekt tjetër teknik që mund të kenë ndodhur.

Prandaj, Banka nuk do të jete përgjegjëse për ndonjë humbje, dëmtim, pasojë të drejtpërdrejtë ose tërthortë që Banka ose Përdoruesi nuk mund të parashikonin brenda një kohe të arsyeshme nga data kur ka filluar përdorimi i Aplikacionin RaiPay ose që janë jashtë kontrollit të Bankes. Për më tepër, Banka nuk do të jete përgjegjëse për pasojat që rrjedhin nga kryerja e pagesave të paautorizuara të shkaktuara nga ekspozimi i pajisjes celulare ndaj viruseve dhe/ose aplikacioneve/programeve të tjera, si dhe nga vjedhjet e tyre.

Për më tepër, Banka nuk do të jete përgjegjëse për:

- çdo humbje ose dëm (moral ose material) i shkaktuar nga mosrespektimi i këtyre Kushteve;
- humbja ose korrupsioni i përmbajtjes së të dhënave të Përdoruesit, nëse një humbje ose korrupsion i tillë nuk është shkaktuar nga Banka ose është jashtë kontrollit të saj. Për më tepër, Raiffeisen Bank nuk është përgjegjës ndaj Përdoruesit/Klientit dhe/ose ndaj palëve të treta për çdo lloj dëmi të drejtpërdrejtë ose tërthortë, duke përfshirë por pa u kufizuar, në humbjen e fitimit, / ose dështimin e kapitalizimit të mundësive të biznesit, ose për ndonjë humbje tjetër të ngjashme që është shkaktuar si rezultat i mosfunksionimit apo funksionimit jo në mënyrën e duhur të Aplikacionit.

12. Juridiksioni

Këto kushte të punës janë përpiluar në gjuhën Shqipe dhe Angleze, dhe rregullohen me ligjet e Republikës së Shqipërisë. Në rast të ndonjë mospërputhjeje midis versionit në gjuhën shqipe dhe versionit në gjuhën angleze të këtyre Kushteve, do të mbizotërojë versioni Shqip.

Palët do të zgjidhin mosmarrëveshjet që rrjedhin nga këto Kushte në mënyrë miqësore. Në rast se palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjet, çdo mosmarrëveshje e mundshme do të zgjidhet para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane.

13. Ndihmë

Nëse Përdoruesi/Klienti has ndonjë vështirësi që lidhet me funksionimin e Aplikacionit RaiPay, lutemi kontaktoni përmes shërbimit të Qendrës së Kontaktit në numrin e mëposhtëm të telefonit:

+355 4 2227262, në dispozicion 24/7.

14. Forca Madhore

Raiffeisen Bank nuk do të jetë përgjigjëse ndaj Përdoruesit për mosrespektimin e ndonjë detyrimi në rast të një forcë madhore dhe, në përgjithësi, në rast të një ngjarje që është jashtë kontrollit të saj, qoftë për mënyrën e operimit, lidhjen me rrjetet e tjera kombëtare dhe/ose të huaja, ashtu edhe për pasojat e aktiviteteve dhe veprimeve të tyre në përgjithësi.

Një forcë madhore mund të jetë, për shëmbull, por pa kufizim: një gjëndje lufte (e shpallur ose jo), konflikt i armatosur, revolucion, kryengritje, veprime apo kërcënime ushtarake ose terroriste, sabotim, trazira civile, greva ose veprime të tjera të punës, ligje, rregullore, vendime ose direktiva, fatkeqësi natyrore, tërmete, zjarre, shpërthime, shqetësime diellore ose të motit, emergjencat publike ose ndonjë ngjarje tjetër përtej kontrollit të Bankës.

15. Përpunimi i të dhënave personale

Banka përpunon të dhënat personale të Klientit, në përputhje me dispozitat ligjore të zbatueshme në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale (Ligjit Nr.9887 dt 10.03.2008 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” te ndryshuar dhe Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (EU /REG 2016/679GDPR).

Kjo dispozitë do të plotësohet me dispozitat e Politikës në lidhje me Mbrojtjen e të Dhënave Personale <https://www.raiffeisen.al/sq/rreth-nesh/faqet-footer/mbrojtja-e-te-dhenave-personale.html>

- **Qëllimi për përpunimin e të dhënave personale**

Banka përpunon të dhënat personale në mënyrë që të përmbushë dhe zbatojë Kontratë/Marrëveshjen specifike për Karten e Debitit / Kartën e Kreditit, për përmbushjen e marrëdhënies kontraktuale me Klientin, në mënyrë që të kryejë operacionet specifike të përcaktuara në Kushtet e Punës të Aplikacionit dhe të sigurojë funksionalitetin e tyre, të specifikuar në kushtet e punës, përfshirë për qëllim të sigurimit të mbështetjes teknike; kryerja e duhur e transaksioneve bankare; optimizimi i shërbimeve financiare dhe bankare; menaxhimi i cilësisë së të dhënave.

Banka gjithashtu mund të mbështetet, në masën e nevojshme, në interesin e saj të ligjshëm për të kryer biznesin e saj, për kryerjen e aktiviteteve të përpunimit në lidhje me përmirësimin e funksionaliteteve të Aplikacionit dhe përvojës së klientit, për identifikimin e rrezeve operacionale për Klientët aktivë në aplikim.

Përdoruesi i Aplikacionit pajtohet shprehimisht dhe e autorizon Bankën të raportojë tek autoriteti mbikëqyrës, me kërkesën e këtij të fundit, të dhënat lidhur me këtë Marrëveshje dhe Aplikacionin RaiPay.

- **Kategoritë e të dhënave personale të përpunuara**

Për të përmbushur qëllimet e përpunimit të lidhura me Kontratën/Marrëveshjen specifike për Karten e Debitit / Kartës së Kreditit, për përmbushjen e marrëdhënies kontraktuale me Klientin, Banka përpunon këto kategori të të dhënave personale: numrin e telefonit të deklaruar nga Klienti në marrëdhënien e tij/ saj me Bankën, numri i identifikimit personal të Klientit ose tjetër numer unik klienti që lidhet me produktin kartë, të dhënat në lidhje me transaksionet e filluara përmes Aplikacionit, të dhënat e kartës (numrin e kartës, datën e skadimit dhe CVV) dhe vendodhjen.

Banka nuk përpunon të dhëna biometrike nga sistemi biometrik i pajisjes celulare të Klientit, të tilla si gjurmët e gishtave dixhital dhe imazhin e fytyrës së Klientit (në atë masë që pajisja e përdorur nga Klienti ka një sistem të tillë biometrik). Këto të dhëna dhe modelet biometrike të lidhura me to janë dhe mbeten të depozituara në pajisjen celulare kur Klienti instalon Aplikacionin dhe i nënshtrohet rregullave të përpunimit, regjistrimit, ruajtjes dhe krahasimit të vendosur dhe komunikuar përmes kësaj pajisje. Refuzimi për të dhënë të dhëna personale mund të rezultojë në pamundësinë e ofrimit të shërbimeve.

- **Burimi i të dhënave**

Për të përmbushur qëllimet e përpunimit dhe për të siguruar funksionalitetet e disponueshme brenda Aplikacionit, Banka merr të dhënat personale direkt nga Klientët.

Banka rekomandon që metoda e vërtetimit të përdoret vetëm nga Klienti në pajisjet që posedon Klienti dhe në të cilat ai / ajo nuk lejon qasjen tek palët e treta. Në atë masë që Klienti u lejon personave të tjerë qasje në metodën e vërtetimit (për shembull, regjistrimi i gjurmëve të gishtërinjve të më shumë se një personi në pajisje, duke lejuar që ai person ta zhbllokojë), me qëllim përmbushjen e qëllimeve të përpunimit të përcaktuara këtu, Banka mund të përpunojë të dhëna personale që i përkasin kategorive të tjera të Subjektit të të Dhënave, pa përfituar, megjithatë, nga metoda praktike e sigurimit të drejtpërdrejtë të informacionit për këto kategori personash. Duke pasur parasysh këtë kontekst, është përgjegjësia e Klientit që të informojë subjektet e të dhënave në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale dhe të marrë pëlqimin e tyre për përpunimin e të dhënave, në masën e nevojshme, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

Nëse Klienti i siguron Bankës të dhëna personale që i përkasin kategorive të tjera të Subjektit të të Dhënave, Klienti duhet të sigurojë vetëm të dhëna të sakta dhe të përditësuara. Në këtë drejtim, Banka mund të përdorë informacionin e kontaktit që i përket kategorive të tilla të Subjektit të të Dhënave në mënyrë që të informojë personat në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale.

- **Vendim-marrje e automatizuar**

Gjatë sigurimit të funksionaliteteve të disponueshme brenda Aplikacionit, Banka nuk kryen procese individuale të automatizuara të vendimmarrjes në lidhje me Subjektet e të Dhënave që shkarkojnë dhe përdorin Aplikacionin.

- **Perhapja e të dhënave personale të palët e treta**

Banka nuk transferon të dhëna personale të klienteve që lidhen me aksesimin dhe përdorimin e platformes nga klientet drejt paleve të treta. Procesuesi i produktit karta debiti/ krediti, RPC përpunon me tej të dhënat që ka në dispozicion, për të mundësuar shërbimin në Aplikacion në formën e një kulete digjitale të instaluar në një pajisje celulare duke përdorur teknologjinë Near Field Communication (NFC) dhe një sistem operativ Android, i cili mundëson regjistrimin dhe leximin e detajeve të Kartës (imazhi dhe 4 shifrat e fundit të serisë së kartave) lëshuar nga Banka dhe regjistruar në Aplikacion nga Përdoruesi, me qëllim kryerjen e pagesave përmes pajisjes celulare.

- **Kohëzgjatja e përpunimit**

Për të përmbushur qëllimet e lartpërmendura të përpunimit, Banka do të përpunojë të dhënat personale gjatë gjithë performancës së shërbimeve bankare, si dhe më pas, kur kjo

kërkon një domosdoshmëri të ligjshme të biznesit (për shembull, në mënyrë që të sigurojë informacionin e kërkuar nga Subjekti i të Dhënave ose në mënyrë që të respektojë detyrimet tona ligjore, tatimore dhe kontabël). Pas skadimit të afateve ligjore për arkivim, Banka mund të vendosë të anonimizojë të dhënat, duke e privuar kështu nga karakteri i saj personal, dhe të vazhdojë përpunimin e tyre për qëllime statistikore.

- **Ruajtja e të dhënave, korrigjimi dhe fshirja e tyre**

Të dhënat personale do të ruhen në mënyrë të sigurtë në aplikacion, për aq kohe sa është e nevojshme sipas qëllimit kryesor të mbledhjes së tyre, e më pas do të anonimizohen. Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kërkojë bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave pa pagesë, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Banka, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së subjektit të të dhënave, do informojë Përdoruesin/Klientin për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e bllokimit, korrigjimit apo të fshirjes. Në raste të veçanta, kur kushtet ligjore pamundësojnë fshirjen e të dhënave, Banka është e detyruar të ruajë informacionin. Në rast të shkeljes të procedurave më lart, Përdoruesi/Klienti ka të drejtën t'i drejtohet Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

- **Të drejtat e subjekteve të të dhënave**

Subjektet e të Dhënave kanë të drejtat e mëposhtme në kontekstin e përpunimit të të dhënave personale nga Banka: e drejta e informacionit/e drejta e aksesit, e drejta e korrigjimit, e drejta e fshirjes („e drejta për t'u harruar“), e drejta për kufizim i përpunimit, e drejta për transferimit të të dhënave, e drejta për të kundërshtuar, e drejta për të mos iu nënshtruar një vendimi të bazuar vetëm në përpunimin e automatizuar dhe të drejtën t'i drejtuar Komisionerit për të drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nëse beson se një masë e tillë është e nevojshme. Pas një kërkesë për fshirjen e të dhënave, Banka mund të anonimizojë të dhëna të tilla (duke e privuar kështu atë nga karakteri i saj personal) dhe të vazhdojë përpunimin e tyre për qëllime statistikore në kushte të tilla.

- **Informacion shtesë dhe të dhëna kontakti për personin përgjegjes për mbrojtjen e të dhënave personale**

Për detaje shtesë në lidhje me aktivitetet e përpunimit të kryera nga Raiffeisen Bank sh.a, si dhe në lidhje me të drejtat e Përdoruesit/Klientit në këtë kontekst, ju lutemi dërgoni një kërkesë me shkrim personit përgjegjes për Mbrojtjen e të Dhënave në Raiffeisen Bank

Shqiperi, duke përdorur adresën e mëposhtme të emailit: E-

Mail: rbal.dataprotection@raiffeisen.al Informacione të detajuara lidhur me aktivitetet e lartpërmendura të përpunimit janë të disponueshme në politikën për mbrojtjen e të dhënave personale në linkun vijues <https://www.raiffeisen.al/sq/rreth-nesh/faqet-footer/perdorimi-i-cookies.html>

Nëse jeni dakord të përdorni Aplikacionin RaiPay, sipas kushteve të parashikuara këtu, si dhe për të dhënë pëlqimin për lidhjen e marrëveshjes, shtypni butonin “Unë pranoj Kushtet dhe Afatet”.

Terms and Conditions for the RaiPay Application

Please fully read these Terms and Conditions prior to the decision of accepting them and continuing the registration process. If you do not agree to any of the provisions of these Terms associated with the RaiPay Application, please do not access or use the Application or software, functionalities, information, material or other such elements included in the Application.

